



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. _____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ . 2019

Lënda: Kthim - përgjigje

Znj. _____

Rruga” _____, Shkodër

Në përgjigje të kërkesës suaj, me nr. 10495.prot, me datë 19.06.2019, “Kërkesë për informim” ju bejmë me dije se Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit është institucion varësie i Bashkisë Shkodër. Ky funksion realizohet në zbatim të pikës 1 dhe 2, nenit 29, të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Sipas këtij neni, Bashkia është përgjegjëse për garantimin e funksioneve të mbrojtjes civile, në nivel vendor dhe administrimin e strukturave përkatëse, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj si dhe garantimin e shërbimit të zjarrfikësve, në nivel vendor dhe administrimin e strukturave përkatëse.

Sipas ligjit 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, neni 2 i këtij ligji, shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin është strukturë e specializuar e gatishmërisë së përhershme. Misioni i këtij shërbimi është inspektimi, parandalimi, me masat e mbrojtjes nga zjarri, ndërhyrja për shuarjen e zjarreve, shpëtimi i jetës, gjësë së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave në aksidente të ndryshme, fatkeqësi natyrore, si dhe në ato të shkaktuara nga dora e njeriut. Sa i përket strukturës, ky shërbim organizohet në nivel qendror dhe vendor. Po sipas këtij ligji, çdo bashki duhet të mbulojë territorin e saj me shërbim zjarrëfikës, me stacione të kompletuara me personel, automjete dhe paisje zjarrëfikëse dhe Kryetari i Bashkisë ka disa kompetenca dhe përgjegjësi që përcaktohen në ligjin “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.

Faleminderit për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

K R Y E T A R

Voltana ADEMI